

Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

NR I VENDIMIT.: KPCC/D/A/127/2011
DATA E VENDIMIT: 26/10/2011

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

- (1) Në secilën prej 21 (njëzet e një) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që paraqitësi i kërkesës ka vërtetuar pronësinë si paraqitës i kërkesës ose si bartës i së drejtës pronësore, sipas rastit, për pronat e kërkuara..
- (2) Në secilën prej 21 (njëzet e një) kërkesave të përmendura në paragrafin (1) më sipër, Komisioni
urdhëron që
 - (a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;
 - (b) Pala përgjegjëse dhe çdo person i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe
 - (c) Nëse pala përgjegjëse ose çdo person që ka uzurpuar pronën, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona.
- (3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar; dhe
- (4) Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit prej bashkëpronarëve përkatës.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-

ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e pestë nga 24 deri 26 tetor 2011 në Prishtinë. Gjithsej i janë paraqitur Komisionit 2,261 kërkesa për pronë bujqësore seancën e njëzetë e pestë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Dy kërkesa për pronë bujqësore të cilat iu paraqitën Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive iu kthye Sekretarisë nga Komisioni për verifikim të mëtejshëm. Gjithsej 2,259 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat të përfshira në këtë vendim

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për 21 kërkesat e identifikuar në listën e bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 2,238 kërkesash për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në vendimet e tjera, pikërisht vendimin KPCC/D/A/126/2011 dhe vendimin KPCC/D/A/128/2011.

9. Të 21 kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat, ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronat e tilla ("Pala përgjegjëse"), ka kundërshtuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079

10. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

1. *Kërkesa kontestuese – mbrojtje e thjeshtë.*

11. Në dhjetë kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar, ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronën e tillë (“Pala përgjegjëse”) ose nuk ka parashtruar ndonjë mbrojtje të vlefshme në përgjigje të kërkesës ose thjesht ka pohuar se ka pasur lejen e paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar pronën, pa ofruar dëshmi në mbështetje të pretendimit. Në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga ana e palëve përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

12. Në kërkesën nr. 35608 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në emër të nënës së tij të ndjerë. Pala përgjegjëse deklaroi se Paraqitësi i kërkesës i ka dhënë leje për të shfrytëzuar pronën. Paraqitësi i kërkesës pranoi se ai i ka dhënë gojariisht leje palës përgjegjëse për të shfrytëzuar pronën, por leja është tërhequr më pas.

13. Në kërkesën nr. 19134 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në emër babait të tij të ndjerë. Pala përgjegjëse pohoi se ka lejen gojore të paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar pronën e kërkuar por nuk ka paraqitur asnjë dokument mbështetës. Paraqitësi i kërkesës e mohon që t'i ketë dhënë ndonjëherë leje palës përgjegjëse dhe kërkon riposelimin e pronës.

14. Në kërkesën nr. 24191 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore në emër nënës së tij të ndjerë. Fillimisht, pala përgjegjëse kërkoj një të drejtë të papërcaktuar ligjore, por më vonë konfirmoi se nuk kërkon të drejtë ligjore për pronën por është i interesuar ta blejë pronën.

15. Në kërkesat nr. 37511, 37513, 37514, 38840, 38841 dhe 38843 paraqitësi i kërkesës fillimisht depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, pikërisht në emër vjehrrit Aleksander Ivkovic. Megjithatë nuk ka paraqitur autorizim nga vjehri që ta përfaqësojë atë. Më pas, paraqitësi i kërkesës ofroi kontratën e dhurimit datë 19 prill 2010 e cila përcakton se vjehri i saj ia transferoi pronësinë e pronave të kërkuara paraqitësit të kërkesës. Aleksander Ivkovic ndërroi jetë më 23 prill 2010.

Në mbështetje të pretendimeve të saj, paraqitësi i kërkesës parashtroi fletën poseduese datë 13 prill 2010 që e tregon Aleksander Ivkovic si pronar të pjesës ideale prej 19/36 dhe Cveta Ivkovic, motrën e Aleksandar Ivkovic, si pronaren e pjesës ideale prej 17/36 të pronës së kërkuar dhe kontratën e dhurimit të datës 19 prill 2010 të nënshkruar nga Aleksander Ivkovic si dhuratë dhënës dhe paraqitësin e kërkesës si pranues i dhuratës me anë të secilës dhuratëdhënësi ia transferon pjesën e tij ideale prej 19/37 të pronës së kërkuar. Të dy dokumentet u verifikuan dhe u konstatuan si të vërteta nga Sekretaria Ekzekutive.

Pala përgjegjëse ka paraqitur dëshmi që tregon se ai ka blerë parcela të ndryshme nga bashkëpronarët Aleksander and Cveta Ivkovic. Megjithatë, ashtu si u pranua nga pala përgjegjëse, këto dokumente nuk ndërlidhen me pronat e kërkuara.

16. Kërkesa nr. 14242, është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposelimin si dhe kompensimin për humbjen e shfrytëzimit të pronës. Në mbështetje të kërkesës së tij ai ka paraqitur një fletë poseduese të datës 21 shkurt 2000

dhe një vendim për ndarjen e pronës së kërkuar të lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë i datës 24 shtator 1985. Të dy dokumentet e paraqesin Paraqitësin e kërkesës si bartës të së drejtës pronësore dhe që të dyja janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta.

Pala përgjegjëse, Milorad Rajkovic, vëllai i Paraqitësit të kërkesës, fillimisht ka kontestuar kërkesën duke pohuar që prona i takon atij. Në mbështetje të pohimit të tij ka paraqitur dokumentet që nuk kanë të bëjnë me pronën e kërkuar. Pala përgjegjëse ka vdekur gjatë vitit 2010 dhe i biri i tij pohon që nuk kërkon asnjë të drejtë ligjore për pronën e kërkuar dhe në të vërtetë ai konfirmon se prona e kërkuar i takon axhës së tij, dmth Paraqitësit të kërkesës.

2. *Kërkesat kontestuese – të tjera.*

17. Në njëmbëdhjetë kërkesat e regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur, pala apo palët të cilët kanë uzurpuar pronat e kërkuara, apo pala e cila ka shpreh një interes ligjor në pronat e tilla (“Palët përgjegjëse”), e kanë kontestuar vlefshmërinë e kërkesës, megjithatë, Komisioni ka arritur në përfundimin që këto kërkesa duhet të aprovohen për arsyet e dhëna më poshtë.

a. Kërkesa nr. 01028

18. Kërkesa nr. 01028 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Ai kërkon konfirmimin e pronësisë dhe riposëdimin e pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur dokumente të ndryshme në mbështetje të kërkesës së tij, përfshirë një kontratë të shitblerjes të datës 23 janar 1984 dhe një fletë poseduese të 25 majit 2004, e cila e paraqet Paraqitësin e kërkesës si bartës të së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive i ka verifikuar të dy dokumentet si të vërteta.

19. Pala përgjegjëse pohon që prindërit e tij të ndjerë ishin pronarë të pronës së kërkuar në fillim të shekullit të njëzetë. Në mbështetje të pohimit të tij ai ka paraqitur një të ashtuquajtur *Tapia*, një dokument i lëshuar nga Zyra Kadastrale Osmane me 8 shkurt 1909, e cila pretendon të dëshmojë pronësinë e prindërve të Palës përgjegjëse për pronën e kërkuar. Megjithatë, dokumenti nuk ofron asnjë identifikim të parcelës së tokës, vetëm një përshkrim për prona të ndryshme duke mos i identifikuar me numër të parcelës.

20. Bazuar në dëshmitë para tij, Komisioni konstaton që Pala përgjegjëse ka dështuar të dëshmojë ndonjë të drejtë ligjore në pronën e kërkuar.

b. Kërkesa nr. 29038

21. Kërkesa nr. 29038 është parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i Paraqitësit të kërkesës, i cili e ka paraqitur kërkesën në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, më saktësisht për vëllanë e tij të ndjerë. Në mbështetje të pohimit të tij Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një fletë poseduese të datës 14 nëntor 2002, e cila e paraqet vëllanë e Paraqitësit të kërkesës si bartës të së drejtës pronësore në pronën e kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë.

22. Pala përgjegjëse pohon që prona e kërkuar ishte në pronësi të familjes së tij deri në vitin 1932 kur prona i është konfiskuar pa asnjë kompensim. Në mbështetje të pohimeve të tij, Pala përgjegjëse ka paraqitur një certifikatë të lëshuar nga arkiva shtetërore e Ish Republikës së Maqedonisë, e gjithashtu edhe një fletë poseduese e cila tregon që anëtarët e familjes të Palës përgjegjëse gjatë vitit 1929 kanë qenë në posedim të parcelave 303/37 dhe 303/47 të cilat gjenden në Komunën e Kpuzit/Klinës. Pala përgjegjëse nuk ka paraqitur asnjë dëshmi në mbështetje të konfiskimit të paligjshëm të pronës së kërkuar.

23. Komisioni konstaton që Pala përgjegjëse dështoi të tregojë të drejtë pronësore konkurruese në pronën e kërkuar.

c. Kërkesa nr. 08894

24. Kërkesa nr. 08894 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, më saktë të gjyshit të ndjerë. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar që gjyshi i ndjerë është i regjistruar në librat kadastrale si pronar i pronave të kërkuara.

25. Pala përgjegjëse pohon që prona e kërkuar i ka takuar gjyshit të tij dhe prona i është konfiskuar në vitin 1918. Komisioni nuk ka juridiksion të vlerësojë vlefshmërinë e mbrojtjes të Palëve përgjegjëse, dhe sido qoftë, është e pakontestueshëm fakti se Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë të vlefshme sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

d. Kërkesa nr. 11440

26. Kërkesa nr. 11440 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, më saktë për gjyshin e tij të ndjerë Trojan Miladinovic. Në mbështetje të kërkesës së tij, Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur tri fleta poseduese, të datës 4 mars 1991, 10 maj 2006 dhe 1 mars 2007, të gjitha e paraqesin Trojan Miladinovic si bartës të së drejtës pronësore të pronës së kërkuar. Sekretaria Ekzekutive verifikuar vlefshmërinë e fletëve poseduese.

27. Pala përgjegjëse pranon se ka disa prona nga babai i ndjerë i paraqitësit të kërkesës, prona e kërkuar në kërkesën nr. 11440 nuk është midis tyre. Megjithatë, Pala përgjegjëse pohon se ka paqartësi rreth kufijve të saktë mes tokës së kërkuar në kërkesën nr. 11440 dhe pronës së afërt të cilën e ka blerë me herët nga babai i ndjerë i paraqitësit të kërkesës. Pala përgjegjëse pranon që mund ta ketë uzurpuar rastësisht pronën e kërkuar për shkak të paqartësisë të kufijve të pronës dhe i ka kërkuar Paraqitësit të kërkesës t'i përcaktojë kufijtë mes pronave të tyre. Në këto rrethana, komisioni ka konstatuar që Pala përgjegjëse nuk e konteston pronësinë e babait të Paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar.

e. Kërkesat nr. 14169 & 90737

28. Në kërkesat nr. 14169 dhe 90737 Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesat në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, më saktë gjyshit të tij të ndjerë. Ai kërkon konfirmimin e pronësisë të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore dhe riposedimin e pronës. Në mbështetje të kërkesës së ai ka paraqitur dy fletë fletë poseduese të datës 13 prill 1988 dhe 3 tetor 2009. Të dy dokumentet e paraqesin babain e ndjerë të paraqitësit të kërkesës si bartës të së drejtës

pronësore për pronat e kërkuara, dhe të dyja janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta.

29. Pala përgjegjëse pohon që gjyshi i tij i ndjerë ishte pronar i pronave të kërkuara gjer në vitin 1918 kur pronat ishin shpronësuar dhe gjyshi i tij ishte dëbuar në Shqipëri. Pala përgjegjëse më tej pohon se babai i tij ishte kthyer në vitin 1940 dhe e kishte marrë në posedim pronën gjer në vitin 1945/46 kur u dëbua nga Partia Komuniste e Jugosllavisë. Komisioni nuk ka juridiksion në vlerësoj vlefshmërinë e mbrojtjes, dhe mbetet e pakontestuar fakti se Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur kërkesë të vlefshme sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

f. Kërkesa nr. 27599

30. Kërkesa nr. 27599 është paraqitur nga personi i autorizuar nga një anëtar i bashkësisë familjare, më saktë vajza e bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore, i cili sipas Kryqit të Kuq është i zhdukur që nga 12 qershori 1999. Komisioni vëren se, ndonëse fleta poseduese dhe certifikata e Kryqit të Kuq të paraqitura nga Paraqitësja e kërkesës janë në emër të Bozidar Cvetkovic, në dokumentet e tjera siç janë certifikata e lindjes dhe ajo e martesës e Paraqitëses të kërkesës emri i babait të Paraqitëses të kërkesës është Bozidar Dusanovic. Paraqitësja e kërkesës ka sqaruar se babai i saj i ka përdorur të dy emrat herë njërin e herë tjetrin. Sekretaria Ekzekutive ka ndërmarrë hetime të mëtejme *ex officio* në Zyrën e Regjistrimit Civil dhe ka vërtetuar që babai i Paraqitëses të kërkesës ka lindur me mbiemrin Cvetkovic.

31. Bazuar në dëshmitë dhe sqarimet e ofruara, Komisioni konstaton që Bozidar Dusanovic dhe Bosidar Cvetkovic është i njëjti person. Komisioni gjithashtu cek që autorizimi është dhënë për kërkesat e paraqitura në "AKM". Është e qartë që në vend të saj do të duhej të ishte "KPA" pasi që të gjithë numrat e kërkesave të regjistruara në dokument aktualisht janë numrat e kërkesave në AKP.

g. Kërkesa nr. 48982

32. Kërkesa nr. 48982 është paraqitur nga Paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore, më saktë babait të tij Bogdan Dajic. Paraqitësi i kërkesës fillimisht ka pohuar që babai i tij është pronari i vetëm i pronës së kërkuar. Gjatë procesit të verifikimit Sekretaria Ekzekutive e ka gjetur një vendim të trashëgimisë të lëshuar nga Gjykata Komunale e Ferizajt me datën 13 tetor 2006 i cili përcakton që Bogdan Dajic ka trashëguar pjesën ideale prej 1/3 të pronës së kërkuar, përderisa pjesa tjetër ideale 2/3 e pronës zotërohet nga një farë Nebojsa Dajic. Përveç kësaj, Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar Certifikatën për të Drejtat e Patundshmërisë të datës 25 gusht 2008, e cila e paraqet Bogdan Dajic si pronar të pjesës ideale të 1/3 të pronës së kërkuar dhe Nebojsa Dajic si pronar të pjesës ideale prej 2/3 të pronës së kërkuar, si të vërtetë.

33. Pala përgjegjëse pohon që babai i tij e ka blerë pjesën ideale prej 2/3 të pronës së kërkuar nga Nebojsa Dajic. Paraqitësi i kërkesës ka pranuar që Nebojsa Dajic ia ka shitur Palës përgjegjëse pjesën ideale prej 2/3 të pronës së kërkuar dhe prandaj ai kërkon vetëm pjesën ideale prej 1/3 të pronës.

34. Kërkesat nr. 15126 dhe 15129 janë paraqitur nga Bosiljka Misic, (Paraqitësja e parë e kërkesës) në cilësinë e bartëses të së drejtës pronësore në parcelat e kërkuara. Kërkesa nr. 27485 është paraqitur nga i biri i Paraqitëses së parë të kërkesës, Nebojsa Misic, (paraqitësi i dytë i kërkesës) në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore për një parcelë tjetër. Paraqitësja e parë e kërkesës kërkon konfirmimin e pjesës ideale prej 2/15 të parcelave të kërkuara. Në mbështetje të pohimeve të tyre Paraqitësja e parë e kërkesës dhe Paraqitësi i dytë i kërkesës kanë paraqitur një vendim të trashëgimisë të datës 15 shkurt 1996 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, duke e shpallur Paraqitësen e parë të kërkesës bashkë-pronare me pjesën ideale prej 2/15 të pronave të kërkuara dhe Paraqitësin e dytë të kërkesës bashkë-pronar me pjesën ideale 1/15 të pronës së kërkuar përkatëse. Më tej, ata kanë paraqitur fletën poseduese të datës 14 gusht 2008 e cila ishte përditësuar pas lëshimit të vendimit të trashëgimisë, duke e paraqitur Paraqitësen e parë të kërkesës si bashkë-pronare të pronave të kërkuara me pjesën ideale prej 2/15 dhe Paraqitësin e dytë të kërkesës si bashkë-pronar me pjesën ideale prej 1/15 të pronës së kërkuar nga ai. Të dy dokumentet janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive.

35. Palë përgjegjëse është kunati i Paraqitëses së parë të kërkesës dhe xhaxhai i Paraqitësit të dytë të kërkesës. Ai pretendon të jetë pronari i vetëm pronave të kërkuara dhe që ai asnjëherë nuk e ka humbur posedimin e këtyre pronave. Megjithatë, dokumentet e verifikuara tregojnë që Paraqitësja e parë e kërkesës, Paraqitësi i dytë i kërkesës dhe Pala përgjegjëse janë bashkë-pronar të pronave të kërkuara. Dëshmitë tregojnë se të dy Paraqitësit e kërkesave kanë humbur posedimin si rezultat i konfliktit të vitit 1999. Rrjedhimisht të tri kërkesat duhet të aprovohen.

36. Nga sa u tha më sipër, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon, se në kërkesat e përfshira në këtë vendim:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar;
- (b) as paraqitësi i kërkesës dhe as bartësi i të drejtës pronësore tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (d) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

37. Rrjedhimisht, pasi që Paraqitësit e kërkesave në secilën kërkesë të përmendur më sipër kanë dëshmuar të drejtën e tyre të pronësisë për pronën e kërkuar, dhe në mungesë të ndonjë mbrojtje të vlefshme nga Palët përgjegjëse, secila nga këto kërkesa duhet të aprovohet.

38. Komisioni vëren se në disa nga këto kërkesa të përfshira në këtë vendim paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo humbjen e shfrytëzimit të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion mbi kërkesat për kompensim.


Rrjedhimisht, kërkesat për kompensim për humbjen e shfrytëzimit duhet të hidhen poshtë.

B. Vërejtjet përmbledhëse

39. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, *d.m.th.* për çdo ndërtesë apo objekt tjetër të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

40. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 e plotësuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuar në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.

41. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesave apo bartësve të së drejtës pronësore, sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e të drejtës së tyre pronësore në pronat e kërkuara para autoriteteve kompetente vendore, siç janë autoritetet kadastrale apo gjykatat vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

* Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA35608	KPA19134	KPA24191	KPA37511	KPA37513	KPA37514	KPA38841
KPA38843	KPA14242	KPA38840				

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA08894	KPA27599	KPA01028	KPA29038	KPA11440	KPA14169	KPA90737
KPA48982	KPA15126	KPA15129	KPA27485			